



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 130, datë 23.12.2013

PËR
MIRATIMIN E KËRKESËS PËR LICENCIM TË Z. NJAZI SHEHU SI VLERËSUES
DËMESH NË SIGURIME

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 23, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, të nenit 89, të Ligjit nr. 9267, datë 29.07.2004 “Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime”, si dhe të Udhëzimit nr. 45, datë 24.04.2013 “Për kriteret, procedurat dhe afatet për rinovimin e licencës/autorizimit të profesionistëve në tregun e sigurimeve”, me propozim të Departamentit të Licencimit dhe Monitorimit, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I :

1. Licencimin e Z. Njazi Shehu, për të ushtruar profesionin e vlerësuesit të dëmeve në sigurime, me cilësimin: vlerësues i dëmeve materiale (motorike dhe të pronës) dhe vlerësues i dëmeve shëndetësore, me afat 5 vjet, në këto grupe sigurimi të jo jetës:
 - sigurimi i aksidenteve dhe shëndetit;
 - sigurime motorike;
 - sigurim nga zjarri dhe dëmtime të tjera në pronë.
2. Ngarkohen departamentet përkatëse për njoftimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Enkeleda SHEHI